




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 12, shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kuvendit të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr 28/1008), dispozitave të nenit 7 të Ligjit Nr. 04/L – 076, për policinë, dispozitave të nenit 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 27/2012 MPB, 03/2012 të MAPL-së për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, dhe nenit 36 shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr. 013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 31.01.2022, merr këtë:

V E N D I M

Për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Neni 1.

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi ka këtë përbërje:

1. Sokol Haliti – kryetar i komunës, kryesues i KKSB-së;
2. Afrim Halili, komandant i Stacionit të Policisë në Viti, anëtar;
3. Basri Aliu, Drejtorja për Shërbime Publike dhe Emergjencë, anëtar;
4. Ibadete Hyseni, zyrtare për barazi gjinore, anëtare;
5. Fatbardha Emini, drejtoresh e Drejtorisë për Arsim – anëtar;
6. Zoran Marinkoviç, përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, anëtar;
7. Radovan Gjuriç, përfaqësues i Komitetit për Komunitete;
8. Gëzim Morina-toger, përfaqësues i FSK-së, anëtar;
9. Husamedin Hoxha, përfaqësues i Bashkësisë Islame në Viti, anëtar;
10. Marjan Uka, përfaqësues i Bashkësisë Katolike në Viti, anëtar;
11. Branisllav Deniç, përfaqësues i Bashkësisë Ortodokse në Viti, anëtar;
12. Zef Marku, përfaqësues i komitetit kroat në Viti, anëtar;
13. Xhemajl Hasani, përfaqësues i bizneseve të Komunës së Vitisë, anëtar;
14. Shyqeri Halabaku, përfaqësues i mediave lokale, anëtar;
15. Tefik Salihu, OJQ “Elita”, anëtar;
16. Adnan Zenuni, kryetar i Komitetit Lokal të Qytetit të Vitisë, anëtar;
17. Bujar Ostërgllava, kryetar i Komitetit Lokal të Fshatit Pozheran, anëtar;
18. Imri Sahiti, kryetar i Komitetit Lokal të Fshatit Smirë, anëtar;
19. Imri Emërllahu, përfaqësues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi;
20. Avdyll Misini, kryetar i këshillit të prindërve.

Neni 2.

Detyrat dhe funksioni i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi janë të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, numër 27/2012, të MPB-së dhe 03/2012 të MAPL-së.

Neni 3.

KKSB është organ këshillues për çështjet e sigurisë në bashkësi, me përfaqësim të gjerë të të gjitha komuniteteve dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile të një komune.

Neni 4.

Gjatë themelimit të KKSB-së janë marr parasysh kriteret e përfaqësimit gjinor, përfaqësimi i drejtë i të gjitha bashkësive etnike dhe fetare.

Neni 5.

Mandati i anëtarëve të KKSB-së është mandat i njëjtë me anëtarët e kuvendit komunal. Ditën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet të gjitha vendimet e mëparshme për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi të Komunës së Vitisë.

Neni 6.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Vitisë.

Neni 7.

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8, lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për procedurat e hartimi dhe publikimi të akteve të komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Shërbimit të Kuvendit;
2. Anëtarëve të KKSB-së;
3. MAPL-së; dhe
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
KRYESUESI

Bekim Azizi

